

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A
DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____/05/2026

Lënda: Procesverbal – Tipi i kontratës- e hapur e thjeshtuar punë

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

I mbajtur sot në datë 14.05.2026 nga anëtarët e Njesisë së Prokurimit, Z. Aleksandër Pjetri, person përgjegjës, i emëruar sipas Urdhërit të Prokurimit me Nr. 474/1 Prot datë 14.05.2026 për procedurën e prokurimit e hapur e thjeshtuar - punë me objekt: “Spostimi i linjave ajrore 35kV L 30-52 Valias - Vorë” me afat 60 ditë nga leja e ndërtimit”.

Arsyet e përdorimit të procedurës së prokurimit

Kjo procedurë e prokurimit zhvillohet në mbështetje të kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi, konkretisht:

- **Ligji nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenet 33 dhe 49, të cilët përcaktojnë detyrimin e autoritetit kontraktues për të zgjedhur llojin e procedurës së prokurimit në përputhje me vlerën dhe karakteristikat e kontratës, si dhe përgatitjen e dokumenteve të tenderit.**
- **Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, nenet 11 dhe 55, të cilët përcaktojnë rregullat për zgjedhjen e procedurës së prokurimit dhe hartimin e dokumenteve të tenderit, përfshirë edhe kushtet për përdorimin e procedurës së hapur të thjeshtuar punë.**

Duke qenë se vlera e parashikuar e kontratës për këtë objekt **bie brenda pragut të përcaktuar në VKM nr. 285/2021 për procedurat e hapura të thjeshtuara për punë**, autoriteti kontraktues ka zgjedhur zhvillimin e prokurimit me **procedurë të hapur të thjeshtuar**, në zbatim të nenit 33 të Ligjit nr. 162/2020 dhe nenit 11 të VKM nr. 285/2021.

Procedura e hapur e thjeshtuar garanton konkurrencë të plotë, transparencë dhe eficiencë administrative, duke qenë procedura e posaçme e përcaktuar nga kuadri ligjor për kontrata punësh me vlerë nën pragun e përcaktuar.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

- Linja ajrore të energjisë elektrike 31321100-3.
- **Punime ndërtimi 45210000-2.**

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

VLERA E FONDIT LIMIT: **7,100,436.26** (Shtatë milion e njëqind mijë e katërqind e tridhjetë e gjashtë presje njëzet e gjashtë) lekë pa TVSH, vënë në dispozicion nga të ardhurat OSSH SH.A për vitin 2026 për objektin: **“Spostimi i linjave ajrore 35kV L 30-52 Valias - Vorë” me afat 60 ditë nga leja e ndërtimit”**.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Drejtoria e Tensionit të Lartë OSSH SH.A ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. *Ofertuesi duhet të paraqesë:*

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. *Ofertuesi duhet të paraqesë:*

2.1 *Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale: Sipas Shtojcës 7 të DST*

2.2 *Kapaciteti ekonomik dhe financiar:*

Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore per vitet (2023, 2024, 2025) lëshuar nga Autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për periudhën e kërkuar duhet të jetë jo me vogël se 40 % e vlerës së përlogaritur të kontratës. (Kërkesa për plotësimin e kapacitetit financiar konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të tre viteve financiare.)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 55, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë :

Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë : 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit, bazuar në pikën 4, të nenit 55, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

Përcaktimi i vitit të kërkuar për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar eshte bere ne mbeshtetje te nenin 43, pika 1 ” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: ” *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklarates të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare*”.

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar se ky kriter kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor **për keestet e maturuara te vitit 2026** sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar). *(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anetar i grupit duhet të dorëzoj vërtetimin lëshuar nga Bashkia në të cilën është rregjistruar sipas QKB-se).*

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. **Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin**”.

Argumentimi: Ky kriter është përcaktuar bazuar në ligjin nr.162/2020 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 76 për kriteret detyruese për skualifikim, si dhe Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.

2.3.1 Kapaciteti teknik:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

- a) Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më e vogël se 30 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet, që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.
- b) Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se vlera limit e kontratës që prokurohet.

Plotesimi i njerit prej dy kushteve te sipërpermdura e ben oferten te kualifikueshme.

Në rastin e bashkimit të operatorve ekonomik:

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

1.2 Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr.9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i perfundimit te kontrates si dhe natyra e punes se kryer);
 - Kontratë Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Aktin e kolaudimit;
 - Çertifikaten e marrjes ne dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes ne dorezim.

Shënim : Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.

- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Kontrate Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Aktin e kolaudimit;

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

- *Fatura tatimore përkatëse të deklaruara në organet tatimore.*

1.1 Per kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontraten e Bashkimit të operatoreve ekonomik si dhe prokuren e posaçme të deklaruar në fazën e tenderimit.

1.2 Per kontratat e realizuara si Nënkontraktor, Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën baze ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe Miratimi zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

2.3.2 Per listen e mëposhtme të mallrave:

- *Shtyllat metalike*
- *Morseteri terheqese dhe mbajtese*
- *Kabell 35kV.*

Jane dhene specifikimet teknike të detajuara në Relacionin Teknik: “Spostimi i linjave ajrore 35kV L 30-52 Valias - Vorë” .

Argumentimi: Specifikimet teknike të shtylles dhe elementeve perberes të saj është bërë sipas Standartit të ri Europian EN 50341 për ndërtimin e “Linjave ajrore elektrike që kalojnë AC 45 kV”.

Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

2.3.2/a Autorizim të prodhuesit/ve/distributorit të autorizuar për listen e mesiperme të mallrave. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Në rastet kur paraqitet autorizim i distributorit të autorizuar, duhet të vërtetohet lidhja e distributorit me prodhuesin.

2.3.2/b Katalog/et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit/për listen e materialeve të mesiperme që do të ofrohen, në të cilën të paraqiten të dhënat teknike baze të përkthyer në gjuhën shqipe.

Shenim: Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë e katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i perkasin.

SKEDA TEKNIKE.

**OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A
DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË**

Nr.	Emërtimi i artikullit	Kompania Prodhuese e artikullit të ofruar	Referenca për specifikimet teknike sipas katalogëve të artikullit të ofruar
1.	Kabell 35kV		
2.	Morsetat		
3.	Shtylla metalike		

2.3.3/c *Operatorët ekonomikë ofertues duhet të paraqesin dëshmi të testimeve zyrtare të kryera për materialet/pajisjet e ofruara, në formën e raporteve laboratorike nga laboratorë të akredituar, certifikatave të pajisjeve sipas standardeve EN/IEC/ISO,SSH, si dhe dokumenteve të tjera të vlefshme të lëshuara nga institucione të autorizuar ose nga prodhuesi/distributori. Këto dokumente duhet të vërtetojnë pajtueshmërinë e materialeve të ofruara (sipas listës së specifikimeve teknike ose materialeve të ngjashme) me kërkesat teknike dhe standardet e detyrueshme të përcaktuara në dokumentet e tenderit.*

Argumentim: Autorizimi i prodhuesit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveç se tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në përputhje me standardet SSH/IEC/DIN/EN. Ky kriter është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës. Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Shenim: Testet duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion apo mund t’i vihen në dispozicion mjetet e pajisjet teknike të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, si me poshtë (sipas formularit përmbledhës të vetedeklarimit):

Nr.	Pershkrimi i mjetit	Sasia	Gjendja
1.	<i>Makineri pusonatrice me kontroll numerik për prodhimin e profileve L nga 30x30x3 deri në 150x150x15 për elementet e shtyllave</i>	<i>1(nje) copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

2.	<i>Kamion transportues vete shkarkues me Vinc mbi 2.5 Ton</i>	<i>1(nje) copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
3.	<i>Makineri punzonatrice me kontroll numerik per shpimin e pllakave me me fortesi tranxhe 100kN</i>	<i>1(nje) copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
4.	<i>Motoarganello</i>	<i>1(nje) copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
5.	<i>Makineri terheqje percj.,tros, OPGW mbi 45 kN</i>	<i>1(nje) copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
6.	<i>Makineri leshuese (frenuese) percj.,tros, OPGW mbi 40 kN (per leshimin ose terheqjen e 1 percjellesve njekoheisht)</i>	<i>1(nje) copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
7.	<i>Falkone (pa motoarg.)</i>	<i>1(nje) copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
8.	<i>Set veglash per kablllo, (Motoperse Hidraulike ≥ 120 Ton)</i>	<i>1 (nje) sete</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>

Si dëshmi për të vërtetuar disponimin e mjeteve dhe pajisjeve teknike ne pronesi/qira do të paraqiten keto dokumenta:

- a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vërteton pronësinë e mjetit: çertifikatën e pronësisë; leja e qarkullimit; çertifikatën e kontrollit teknik; siguracionin; lejen e transportit që lëshohet nga njësia vendore dhe fotot përkatëse;*

Ndërsa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë, e cila duhet të përfshijë objektin përkatës dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve.

- b) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore përkatëse, fotot, ndërsa për mjetet e marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë, e cila duhet të përfshijë objektin përkatës dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve.*

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar dhe i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentimi Kërkesa e mesiperme eshte vendosur sipas pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa ”d” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Nepermjet ketyre kerkesave, Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kane në dispozicion apo që mund t’u vihen në dispozicion me qellim permbushjen me sukses te kontratës objekt prokurimi.

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zerave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialistet e fushës. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të Preventivit. Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 216 datë 13.04.2023 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”. Dokumentacioni shoqëruet i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet Kontratës së Shtitjes apo Kontratës së Qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci Autoritetit Kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të Grafikut të Punimeve (i cili do të publikohet së bashku me Dokumentat e Tenderit).

Shënim: Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin...”, sjellim ne vemendje se:

- Disponimi i punonjësve dhe i mjeteve/pajisjeve të kërkuara do të dëshmohet nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit gjatë fazes së ofertimit.
- Autoriteti/enti kontraktor përpara fazes së nenshkrimit të kontratës do t’i kërkojë ofertuesit fitues i klasifikuar i pari nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të kërkuara sipas Shtojcës 8 të DST. Mosparaqitja e dokumentacionit për disponimin e punonjësve, mjeteve/pajisjeve do të jetë kusht s’kualifikimi.
- Autoriteti Kontraktor do të bejë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimin e bërë gjatë fazes së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përben kusht s’kualifikimi.

Makineri pusonatrice me kontroll numerik për prodhimin e profileve L nga 30x30x3 deri në 150x150x15 për elementet e shtyllave - 1(nje) cope.

Makineria pusonatrice është kërkuar për prodhimin/pershtatjen e profileve të elementeve të shtyllës, sipas permasave përkatëse të shtyllës së projektuar.

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

1. Kamion transportues vete shkarkues me Vinc mbi 2.5 Ton - 1(nje) cope Eshte kerkuar kamioni per shkak te natyres se punimeve ne preventiv si per transportin e materialeve te shtylles edhe ato te germimeve te dheut.

2. Makineri punzonatrice me kontroll numerik per shpimin e pllave me me fortessi tranxhe 100kN 1(nje) copë Pronësi ose me qera
Ashtu si makineria pusonatrice per prodhimin/pershtatjen e profileve te elementeve te shtylles, eshte kerkuar edhe kjo per shpimin e elementeve te shtylles per te bere lidhjen e tyre me bullona.

3. Motoarganello - 1 (nje) copë Pronësi ose me qera
Motoarganello eshte makineri e nevojshme per terhqjen e percjellsave te fazes se linjes 35kV te shtyllave te reja.

4. Makineri terheqje percj.,tros, OPGW mbi 45 kN - 1(nje) copë

Makineri e nevojshme per terhqjen e percjellsit te trosit te linjes 35kV te shtyllave te reja.

5. Makineri leshuese (frenuese) percj.,tros, OPGW mbi 40 kN (per leshimin ose terheqjen e 4 percjellesve njekohesisht) - 1(nje) copë.

Kjo makineri eshte kerkuar per te realizuar punimet sa me shpejt duke punuar ne te gjithë percjellesit e linje njekohesisht, ne menyre qe te ulet koha e kufizimit te nderprerjes se energjise ne linjen 35kV si per systemin energjitik po ashtu edhe per konsumatoret.

6. Falkone (pa motoarg.) - 1(nje) copë.

Kërkohet për realizimin e mbështetjes dhe stabilizimit mekanik të elementëve të linjës gjatë montimit dhe operimit të saj. Ky element shërben për garantimin e qëndrueshmërisë strukturore, shpërndarjen e ngarkesave mekanike dhe ruajtjen e parametrave teknikë të projektit në përputhje me kërkesat e sigurisë dhe standardet teknike të zbatueshme për ndërtimin e linjave elektrike. Specifikimi është përcaktuar në funksion të nevojave konkrete të objektit dhe nuk kufizon konkurrencën, pasi pranohet çdo produkt ekuivalent që përmbush parametrat teknikë dhe funksionalë të kërkuar.”

7. Set veglash per kablllo, (Motoperse Hidraulike \geq 120 Ton) - 1 (nje) sete

Makinerite e tjera jane te nevojshme per keto proces specifik pune, ne ngritjen e elementeve konstruktive te shtyllave.

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

Shënim: Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njësuara me origjinalin...”, sjellim ne vemendje se:

- Disponimi i punonjësve dhe i mjeteve/pajisjeve të kërkuara do të dëshmohet nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit gjatë fazes së ofertimit.
- Autoriteti/enti kontraktor përpara fazes së nënshkrimit të kontratës do t’i kërkojë ofertuesit fitues nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të kërkuara sipas Shtojcës 8 të DST. Mosparaqitja e dokumentacionit për disponimin e punonjësve, mjeteve/pajisjeve do të jetë kusht s’kualifikimi.
- Autoriteti Kontraktor do të bejë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimin e bërë gjatë fazes së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përben kusht s’kualifikimi.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të ketë licencën e zbatimit si mëposhte:

a) Liçensa profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës.

Operatori ekonomik ofertues, duhet të dëshmojë se dispononë liçensë profesionale për zbatim punimesh në ndertim ose ekuivalentet e tyre, duke përfshirë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin liçensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndertimi”, i ndryshuar.

Punime të përgjithshme ndertimi:

Kategoria NP-I	Punime gjurmimi në tokë	Klasifikim A
Kategoria NP-II	Ndertime për N/stacionet, kabinat e transformatorve, linjat TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë	Klasifikim A

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

Kategoria NS-8	Ndertime parafabrikat, beton/arme, struktura metalike dhe druri	Klasifikim A
----------------	---	--------------

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzoj licencat profesionale sipas zërave të preventivit që në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit merr përsipër të realizojë).

Për Operatorët Ekonomikë të huaj, licencat profesionale të kërkuara sipas legjislacionit shqiptar duhet të njihen ose të ekuivalentohen me licencat profesionale të lëshuara nga vendi i origjinës. Operatorët e huaj duhet të paraqesin dokumentacionin përkatës që vërteton njohjen ose njehsimin/equivalencën e licencës së tyre pranë institucionit kompetent në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Kjo bëhet në plotësim të kërkesave për zotërimin e licencave profesionale të domosdoshme për ekzekutimin e kontratës.

Shenim: Ne rast pjesmarrjeje te nje Operatori ekonomik te huaj, ky i fundit, Licencen e mesiperme me kategorite e pershkruara, duhet ta kete te njehsuar prane organeve perkatese ne Republiken e Shqiperise sipas legjislacionit te saj ne fuqi.

Shënim: Në zbatim të nenit 39 “Kërkesa të vecanta për kontratat për punë publike”, të VKM Nr. 285, datë 19/05/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Autoriteti Kontraktor lejon mundësinë që projektimi mund të nënkontraktohet, apo që ofertuesi (zbatuesi i punimeve) të paraqesë kontratë bashkëpunimi me subjekte që operojnë në fushën e projektimit dhe që plotësojnë të gjitha kriteret e hartuara nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë qëllim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendim te Këshillit te Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008, ”Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies se licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, gjithashtu të dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton “Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore.

Kjo kategori punimi janë në përputhje me zërat e preventivit paraprak dhe objektin e prokurimit, janë proporcionale dhe te lidhura ngusht me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Kjo kërkesë lidhur me licencën profesionale të shoqërisë është në përputhje me Nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe pika 6/a, e nenit

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

39, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

- Referuar N.P-1 (Punime gërmimi në tokë), në preventivin e punimeve ka zera që kanë të bëjnë me gërmimin e bazamenteve në tokë ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me piken N.P-1, me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

Persa i përket kërkeses për Licencën kategoria NP – 1, lidhur me punimet e gërmimit në tokë dhe Klasifikimi – A, ju bëjmë me dije se kjo kërkesë i është referuar Preventivit të punimeve për objektin ndertimin të linjes ku punimet për bazamentet e shtyllave sipas përshkrimeve dhe shenimeve teknike në vizatimet e detajuara të bazamenteve të shtyllave, të cilat janë në dokumentet teknike të projektit, dhe kërkojnë punime gërmimi për realizimin e tyre.

- Referuar NP – 11 (Ndertime për N/stacionet, kabinat e transformatorve, linjat TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë), në preventivin e punimeve pjesa më e madhe e zerave dhe natyra e vetë këtij objekti kërkojnë që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me piken N.P-11, me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

Kategoria NP – 11 është domosdoshmerisht e nevojshme për OE, sepse shtyllat e reja 35kV do të ndertohen në linje ekzistuese dhe duhet të sigurojnë qëndrueshmërinë fizike, të saj dhe kjo kërkon person të kualifikuar për këto lloje punimesh specifike.

Pavaresisht vlerës së fondit për këtë projekt, është kërkuar kategoria A, sepse janë punime specifike në N.Stacione elektrike të shpërndarjes së energjisë me nivel tensioni 35kV.

- Referuar N.S-8 (Ndertime parafabrikat, beton/arme, struktura metalike dhe druri) Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen me struktura metalike si janë shtyllat e tipit kulle, apo elemente të tjera beton arme të bazamenteve të shtyllave, për këto është e nevojshme që Operatori ekonomik të jetë i licensuar për kategorinë N.S-8, me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

Kërkesa e kategorisë së punimeve NS – 8 për objektin e mesipër gjithashtu është një kërkesë e domosdoshme, që lind nga llogaritja e qëndrueshmërisë mekanike dhe dinamike të shtyllës, percjellesve të saj dhe elementeve perberes në kushte normale pune por edhe ato ekstreme të motit si janë era, debora dhe ngricat.

Kjo kategori duhet gjithashtu që nga prodhimi i elementeve perberes të shtyllës të cilat kalojnë në proces teknologjik zinkimi për të rritur qëndrueshmërinë ndaj kushteve korozive të ambjentit, dhe montimi i gjithë elementeve perberes të tyre duke krijuar funksionim normal të furnizimit me energji elektrike, qëllimi kryesor që shtylla e re ka.

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

Tipi i shtyllës 35kV është model 6Z.

b) Liçensa profesionale në fushën e projektimit.

Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me licencë profesionale në fushën e projektimit ose të ketë marrëveshje kontraktuale me disponuesit e këtyre licencave, leshuar nga organet përkatëse, e cila të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

<i>Projektues konstruktor</i>	- Pika 3/a,b
<i>Projektim N.Stacione elektrike primar, sekondar – linja të tensionit të lartë.</i>	- Pika 10/d

Argumentimi: Këto kategori projektimi janë në përputhje me zërat e preventivit paraprak dhe punimet përkatëse për objektin e prokurimit, këto janë proporcionale dhe të lidhura ngushtë me realizimin e punimeve, natyrën dhe vlerën e kontratës. Kjo kërkesë lidhur me licencën profesionale të shoqërisë është në përputhje me Nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe pika 6, e nenit 39, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Argumentim teknik për kërkesën mbi licencat profesionale në fushën e projektimit

Në përputhje me natyrën dhe kompleksitetin teknik të objektit të prokurimit, që përfshin ndërtimin e linjave të tensionit të lartë dhe dy nënstacioneve të transmetimit, realizimi i këtij projekti kërkon përfshirjen e ekspertizës së specializuar në fushën e projektimit të strukturave, instalimeve elektrike, impianteve të shpërndarjes së energjisë elektrike dhe sistemeve të elektronikës dhe telekomunikacionit. Për këtë arsye, në dokumentet e tenderit është përcaktuar që Operatori Ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me licencë profesionale përkatëse, ose të ketë marrëveshje kontraktuale me subjektet që i zotërojnë këto licenca, të lëshuara nga organet kompetente për licencimin e shërbimeve të projektimit.

Konkretisht, kërkohet që dokumentacioni i ofertës të përfshijë licencat ose marrëveshjet për këto kategori projektuesish:

- *Projektues konstruktor – Pika 3/a, b: për projektimin e strukturave mbajtëse të linjave dhe objekteve ndihmëse në nënstacione, duke garantuar siguri dhe stabilitet mekanik sipas normave të ndërtimit.*
- *Projektim N.Stacione elektrike primar, sekondar – linja të tensionit të lartë. – Pika 4/d: për projektimin e instalimeve elektrike në N.Stacione dhe linja të tensionit të lartë dhe të mesëm sipas spostimit të llinjes TL që është qellimi i kësaj kontrate.*

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

Këto licenca përbëjnë një garanci teknike dhe ligjore që operatori ofertues ka kapacitetin profesional dhe ekspertizën e nevojshme për të realizuar projektimin e plotë dhe të sigurt të komponentëve të kësaj vepre energjetike të rëndësishme.

Gjithashtu, OE ofertues mund të kontraktoje disponuesit e këtyre licencave, nese nuk jane pjese e stafit te tij, me qellim realizimin e kontrates.

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë kapacitet minimale të fuqisë punëtore për realizimin e objektit të prokurimit. Në përputhje me nenin 11, shkronja ‘a’ të Ligjit nr. 9136, datë 11.09.2003 “Per mbledhjen e kontributeve te detyrueshme te sigurimeve shoqerore dhe shendetesore ne Republiken e Shqiperise”, kërkohet që operatori ekonomik të ketë pasur **jo më pak se 10 punonjës gjatë tre (3) muajve të fundit**, duke përfshirë **detyrimisht listëpagesën e muajit të fundit** para datës së hapjes së procedurës së tenderit:

- *4 (kater) elektrikiste punonjës specialist të pajisur me OMVK ne perputhje me kerkesat ose standartet ekuivalente te cilet duhet te kene njohuri teorike dhe praktike të teknologjisë së instalimeve të tensionit të lartë dhe të rregullave që mundësojë montimin, ripariminin, mirëmbajtjen, çmontimin e instalimeve të tensionit të lartë në përputhje me kategorinë e tyre për elektrikist.*
- *Ku minimalisht 2 (dy) specialist të kenë kategorine, e IV ose më e lartë dhe pjesa tjetër te jene te pajisur me OMVK per elektrikist. Pjesa tjetër e puntorve të kërkuar të jenë punonjës ndihmës.*

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar dhe i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Eshtë e mjaftueshme paraqitja e deklarates, sipas shtojcës nr.8, duhet te dorezoje dokumentacionin si më poshtë:

- *Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën tre muajt e fundit.*
- *Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën tre muajt e fundit.*

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

ekzekutimin e objektit të prokurimit, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Në përcaktimin e numrit të punonjësve specialistet e fushës kanë bërë një analizë bazuar tek faktorët, si volumet dhe kategoritë e punimeve, kualifikimi i punonjësve, grafiku i punimeve, zërat e punimeve dhe orët e punës që duhen për të përmbushur kontratën. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje tre mujore nga data e zhvillimit të tenderit, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës. Po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për një punësim të paktën 10 punonjës duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën e punimeve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në mënyrë të përmbledhur numri i fuqisë puntorë që kërkohet për realizimin e punimeve është minimumi 10 punonjës.

Me poshte jepet arsyetimi per numrin minimal te punonjesve prej 10 veta te llogaritur per realizimin e punimeve kryesore te cituara me lart.

Per cdo proces pune llogaritenoret totale duke shumezuar oret e punes njesi me sasine sipas preventivit. Keto sasi oresh pjestohen me ditet e punes (26) x afatin e punimeve i ndryshem per cdo process pune x 8 ore pune ne dite sipas Kodit te Punes.

➤ *Numri i punonjesve te montimit te shtyllave.*

Per montim 1 ton konstruksion metalik ne shtylla TL duhen 72 ore pune/ton x 5.5 ton = 396 ore pune,

Pjestuar me (8 ore pune/dite x 26 dite x 0.5 muaj) = 6 punonjes per montimin e shtyllave.

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

- *Shtrimi i percjellesave.*

Punime shtrirje terheqje percjellesi ACSR ne shtylla TL 113 ore/km x (1.1 km percjelles) = 124.3 ore pune ne total.

Pjestuar me (8 ore pune/dite x 26 dite x 0.2 muaj) = 4 punonjes

- *Shtrimi i kabllit TM 35kV, 120mm².*

Punime shtrirje kabllie 35kV me gjatesi rreth 120m, 0.34 ore /ml = 40.8 ore pune ne total.

- *Punime civile germim dheu dhe punime betoni*

Punime betoni dhe beton arme ne bazamentet e shtyllave 12.9 ore/m³ x 10m³ = 129 ore pune ne total.

Nga analiza e detajuar me siper per fuqine punetore :

- 1. Punime montimi shtylla, civile dhe betoni 6 punonjes.*
- 2. Punime demontimi dhe Shtrirje kablli 4 punonjes.*

Numri i punonjesve te kerkuar prej 10 vete eshte minimalisht i nevojshem dhe i domosdoshem per realizimin e plote te punimeve brenda afatit te kerkuar prej 3 muaj te projektit.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar dhe i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij teknik, të punësuar me kontratë pune ose me kontratë shërbimi për periudhën e zbatimit të kontratës, personel të kualifikuar teknikisht, të përbërë nga:

- 1 (një) Inxhinier Elektrik*
- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi*
- 1 (një) Inxhinier Mekanik*

Të gjithë specialistët e mësipërm qe jane me kontrate pune duhet të jenë të siguruar dhe të figurojnë në listëpagesat përkatëse E-Sig për të paktën 3 (tre) muajt e fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Ne rastin kur jane me kontrate shërbimi duhet te paraqitet e kontrata e shërbimit per perjudhen e zbatimit te kontrates.

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar dhe i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentim: Në lidhje me kërkesën për inxhinieret e kerkuar, është vendosur duke marrë në konsideratë volumin e punimeve objekt kontrate dhe për ti dhënë siguri Autoritetit Kontraktor që OE fitues do të arrijë të realizojë punimet e kerkuara. Numri i personelit kryesor i nevojshem për këtë kategori është minimal dhe nuk kufizon konkurrencën. Këto kërkesa për kualifikim janë në përputhje me piken 6/c te nenit 39, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, si dhe me Nenin 77 të të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

- Për sa i takon inxhinierit elektrik të kërkuar, është të nevojshëm për zbatimin e kontratës pasi inxhinieri elektrik do të ndjekin ecurinë e punimeve elektrike që nga projektimi deri në zbatimin e plotë të investimit, duke patur parasysh natyrën e investimit që do të kryhet.*
- Për sa i takon inxhinierit të ndërtimit të kërkuar, janë të nevojshëm për zbatimin e kontratës pasi inxhinierët e ndërtimit janë ekspertët kryesor për projektimin dhe zbatimin duke patur parasysh natyrën e investimit që do të kryhet.*
- Për sa i takon inxhinierit mekanik të kërkuar, është të nevojshëm për zbatimin e kontratës pasi inxhinieri mekanik do të ndjekin ecurinë e punimeve mekanike si montime dhe demontime të pajisjeve dhe konstruksioneve mekanike të investimit në rastin konkret sic janë shtyllat e kesaj linje si pjesë e këtij e projekti te shprehura ne preventivin perkates.*

AK argumenton se kërkesa për inxhinieret është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

2.3.8 Operatori ekonomik (ne baze te Ligjit 10237, dt. 18.02.2010, neni 5, pika 15) per miratimin e rregullores per sigurine ne kantier) duhet te kete te pakten 1 (nje) person te trajnuar dhe te pajisur me certifikate si pergjegjes per sigurine dhe shendetin ne pune me risk te larte, dhenien e ndihmes se pare dhe menaxhim emergjencash, i cili te jete i siguruar te pakten per 3 (tre) muajt e fundit dhe duhet te jete prezent ne kantier gjate ekzekutimit te punimeve. ose lejohet edhe me kontrate bashkepunimi në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier". Per kete duhet te paraqitet certifikata e trajnimit per “Pergjegjes per sigurine dhe mbrojtjen e shendetit per pune”, e dhene nga nje organizem i akredituar, shqiptar ose i huaj si dhe kontrata e punes/ edhe me kontrate

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

bashkepunimi Ne rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter do te permbushet nga te gjithë anetaret e BOE ne perputhje me perqindjen dhe /ose natyren e pjesemarrjes ne pune sherbim apo furnizim te percaktuara ne aktmarreveshje .

Certifikata te jete e leshuar nga shoqeri te licencuara nga ministria perkatese.

Lidhur me kete pike operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje:

- 1. Çertifikaten e punonjësit të kualifikuar;*
- 2. Listpagesat E-Sig te punonjesit te sipercituar.*

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar dhe i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentimi: Persa i perket kerkeses per nje person te trajnuar dhe te pajisur me certifikate si pergjegjes per sigurine dhe shendetin ne pune me rrisk te larte, argumentohet se eshte i nevojshem te qendroje ne kantierin e punimeve per te ndjekur ecurine e punes se punonjesve te OE ofertues dhe te jete i gatshem ne rastin e paraqitje se kushteve te rrezikshme qe mund te ndodhin gjate zbatimit te kontrates objekt prokurimi, ne perputhje me Ligjin Nr. 10237, date 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, i ndryshuar.

Kjo kërkesë është në përputhje me Nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe pika 6/c, e nenit 39, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.3.9 Operatori Ekonomik duhet te kete te punesuar ose me kontrate sherbimi te pakten 1 (nje) manovrator,i cili duhet te jene te pajisur me karteles personale te sigurimit teknik, te leshuar nga organet kompetente, te cilet te jene te siguruar te pakten per 3 (tre) muajt e fundit nga data e publikimit te njoftimit te kontrates (nese automjetet jane ne pronesi te OE ofertues).

Ne rastin kur automjetet merren me qira, manovratori i pajisur me karteles personale te sigurimit teknik, mund te kontraktohet nga OE ofertues per realizimin e kontrates objekt procedure prokurimi.

Ne lidhje me manovratorin e makinerive te renda te paraqiten deshmite e drejtimit te leshuar nga Ministria perkatese.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar dhe i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentimi: Në lidhje me punonjësit manovrator te kerkuar, theksojme se keta punonjes duhet te disponohen dhe te kene eksperience te nevojshme per te bere te mundur levizjet brenda kantierit te nderitmit, duke patur ne konsiderate kufizimet e mundshme brenda territorit te kantierit.

Keto kërkesa janë në përputhje me Nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe pika 6/c, e nenit 39, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.3.10 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat si më poshtë:

- a) *Certifikatën e cilësisë së punimeve SSH/DIN/EN/UNI/ISO 9001-2015 e perditesuar (e vlefshme)/ose/ekuivalent. Certifikata të jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.*
- b) *Certifikatën për Sistemin e menaxhimit të mjedisit SSH/DIN/EN/UNI/ISO 14001-2015 e perditesuar (e vlefshme). /ose/ ekuivalent. Certifikata te jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.*
- c) *Certifikatën SSH/DIN/EN/UNI-ISO 45001:2018 përditësuar, (SSH/DIN/EN/UNI/ISO 45001 – 2023) e vlefshme/ ose ekuivalent (Mbi Sistemet e menaxhimit të shendetit dhe sigurisë të punëtorëve në punë ose ekuivalent). Certifikata te jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.*

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, Operatori ekonomik do te paraqese ISO-t në baze te zerave te punimeve qe ka marre persiper te realizoje.

Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH/DIN/EN/UNI/ISO mbi komformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A **DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË**

ISO 9001- është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t'i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001- ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrorjnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

ISO 45001- është standard ndërkombëtare, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, sjellim ne vemendje se:

- Dokumentet perkatese vertetuese per disponimin e punonjësve do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.
- Autoriteti/enti kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit do t'i kërkojë ofertuesit të kualifikuar nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të paraqitura në sistemin elektronik të prokurimit gjatë fazës së ofertimit. Mosparaqitja e dokumentacionit të sipërcituar do të jete kusht s'kualifikimi.

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

- *Autoriteti Kontraktor do te beje verifikimin e dokumentacionit ne perputhje me vetedeklarimet e bera në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit te dorezuar perben kusht s'kualifikimi.*

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26 pika 7 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar.

Në të gjitha rastet ku është përmendur fjala markë, Autoriteti Kontraktor do të pranojë edhe "ekuivalentin" e tij/tyre.

Në të gjitha rastet kur AK në specifikimet teknike i është referuar vetëm standarteve europiane, Autoriteti Kontraktor do të pranojë edhe paraqitjen e standarteve SSH/DIN/EN/UNI/ISO.

Shënim 2 : Bazuar në parashikimet e Rr.P.P. miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar, ku konkretisht në pikën 6, të nenit 26, parashikohet:

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin...

Përsa më sipër, ofertuesi i kualifikuar, i pari, duhet të dorëzojë pranë autoritetit kontraktor dokumentacionin, e parashikuar në pikën 6, të nenit 26, të Rr.P.P., brenda afatit 5 ditor që ka në dispozicion autoriteti kontraktor, për publikimin e njoftimit të fituesit paraprak, sipas nenit 97/1, të LPP-së.

Shënim 3: Në respekt të nenit 36 të Ligjit Nr. 162 datë 23/12/2020 "Për prokurimin publik" në të gjithë rastet kur në DT, preventiv, specifikime teknike apo çdo dokument shoqërues është cituar ndonjë markë, përfshihet termi "ose ekuivalent i tij/i saj", pasi në cdo rast emërtimi është bërë për arsye orientimi dhe nuk ka efekt kufizues apo përjashtues.

Kudo në specifikimet Teknike ku është cituar Standart ndërkombëtar do të pranohet edhe cilësim ekuivalent nga një institut vendor.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

Kohëzgjatja 60 ditë nga dorezimi i sheshit.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike të përcaktuara në Dokumentet e Standartizuara të Tenderit (DST) janë hartuar në përputhje të plotë me të dhënat dhe kërkesat teknike të parashikuara në projektet e zbatimit. Këto projekte, të cilat janë pjesë përbërëse e dokumentacionit të tenderit, janë dërguar nga Zyra e Projekteve pranë Drejtorisë së Tensionit të Lartë, OSSH sh.a., dhe përmbajnë të gjitha shënimet, parametrat teknikë dhe kushtet e domosdoshme për realizimin e punimeve.

Bazuar në relacionin e ardhur nga grupi i punës i ngritur me nr. Prot 193/1 datë: 02.03.2026 “Për përlllogaritjen e fondit limit”, ku bashkëlidhur kanë sjellë në sektorin e prokurimeve, specifikimet teknike, kritere e vecanta kualifikuese objekt prokurimi. Specifikimet teknike të dërguara, plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 36, 49 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe nenin 78,55 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar - njësia e prokurimit kreu miratimin kritereve teknike si dhe specifikimeve teknike objekt prokurimi.

- Më pas u diskutuan të gjithë kapitujt e dokumentave të tenderit dhe Njësia e Prokurimit bëri miratimin e dokumentave të tenderit.
- Dokumentat u printuan dhe u firmosën në çdo faqe nga të gjithë anëtarët e Njesisë së Prokurimit.

Në përfundim u vendos vazhdimi i mëtejshëm i procedurave ligjore të prokurimit.

❖ Njesia e Prokurimit

Aleksandër Pjetri **Përgjegjës prokurimi**